

# RAPORT VJETOR -SIGURIMI I CILËSISË

**Viti akademik 2020/2021**

**30 nëntor 2021**

## Përmbajtja

Akronimet: .....	2
1. Hyrje .....	3
2. Menaxhimi i cilësisë .....	5
2.1 Organizimi dhe procedura e sigurimit të cilësisë në Akademinë "Evolucion" .....	5
3. Realizimi i procesit mësimor .....	6
3.1 Norma e kalueshmërisë së studentëve në provime .....	8
3.2 Numri i të diplomuarve .....	8
3.3 Shkëputje e studimeve .....	10
4. Vijueshmëria e studentëve në ligjërata .....	10
4.1 Semestri dimëror .....	10
4.2 Semestri verorë .....	13
5. Administrata .....	15
6. Biblioteka e Akademisë "Evolucion" .....	16
6.1 Shërbimet Elektronike dhe mediat sociale .....	17
7. Aktivitetet dhe projektet .....	18
8. Anketimi .....	19
9. Regjistrimi i studentëve të rinj për vitin akademik 2021/2022 .....	20
10. Konkluzion .....	21

**Akronimet:**

<b>AE</b>	Akademia Evolucion
<b>DM</b>	Dizajni i Modës
<b>DK</b>	Dizajn i Komunikimit
<b>DE</b>	Dizajn i Enterierit
<b>ZSC</b>	Zyra e Sigurimit të Cilësisë
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>IKSHPK</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

## 1. Hyrje

Rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19 në Republikën e Kosovës ashtu si edhe në tërë botën, ndryshuan rrjedhën e punës të të gjitha institucioneve dhe veprimtarive. Kjo pandemi ndikoj dukshëm edhe në organizimin e procesit mësimor në Republikën e Kosovës. Gjatë pandemisë COVID-19, si të gjitha institucionet arsimore në vend edhe Akademia "Evolucion" u detyrua t'i zhvendos menjëherë të gjitha aktivitetet arsimore në platformën online.

Duke ju referuar strikt vendimeve të IKSHPK-së dhe të Qeverisë së Kosovës për ndërprerjen e procesit mësimor-edukativ në Republikën e Kosovës, për shkak të masave parandaluese të përhapjes së pandemisë koronavirusit (COVID –19), dhe me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë të procesit akademik dhe minimizimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo situatë e jashtëzakonshme, menaxhmenti dhe stafi akademik i Akademisë "Evolucion" pa humbur kohë është angazhuar për identifikimin e mundësive dhe ofrimin e kushteve për organizimin e procesit të mësimin në distancë (online) për vitin akademik 2020-2021. Si pasojë e gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, Akademia "Evolucion" e ka filluar mësimin në distancë me datë 18.10.2020

Sipas dispozitave të statutit, Rregullorës për Sigurim të Cilësisë dhe rregulloreve të tjera në Akademinë "Evolucion", (AE) Menaxhmenti i AE-së mori vendim për një përgatitje rigoroze për të filluar vitin e ri akademik 2020/2021 me sfida që i kishim përpara. Në kuadër të këtij vendimi, stafi menaxherial dhe administrativ i AE-së i aktivizoj ekipet punuese të cilat ishin të themeluara që në fillim të pandemisë në vitin 2020. Në kuadër të grupit punues të drejtuar nga këshilli akademik, janë përfshirë:

- Staf i administrativ
- Staf i akademik
- IT-ja
- Zyra për sigurimin e cilësisë

Në kuadër të këtij vendimi, ky grup punues u angazhua në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve për ta mundësuar dhe lehtësuar mësimin online dhe për të reduktuar sa më shumë dëmet në mësimdhënie të shkaktuara nga kjo situatë e jashtëzakonshme.

Procesi i organizimit dhe majtjes së mësimin online (dhe atij të kombinuar) gjatë vitit akademik 2020/2021 ishte dukshëm më i lehtë, kjo falë përvojës së fituarar të profesorëve, studentëve dhe grupit punues me procesin mësimor online i cili filloj të zbatohet që nga viti 2020.

Raporti vjetor për sigurimin e cilësisë siguron një pasqyrë të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë të cilit i nënshtrohet çdo segment i punës së AE-së. Si i tillë, raporti përshkruan formën e zhvillimit të procesit mësimorë gjatë vitit akademik 2020/2021 në AE me kushtet, procedurat, ndikimin e mësimin online, vlerësimin e performancës së studentëve sipas departamenteve, monitorimin e procesit të punës së administratës dhe mësimdhënies.

Në vitin akademik 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 Akademia "Evolucion" ka regjistruar 557 studentë në programet e saj ekzistuese.

Nga këta, Departmenti i Dizajnit të Modës ka 333 studentë, Departmenti Dizajnit të Komunikimit ka 108 studentë, Department i Dizajnit të Enterierit ka 59 studentë, dhe i Dizajnit të Modës (MA) ka 57 studentë. Paragrafët në vijim prezantojnë më në detaje të dhënat dhe statistikat mbi numrin, strukturën dhe informata tjera mbi studentët.

Tabela me numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në nivelin bachelor dhe master në vitet akademike 2019-2020, 2020/2021 dhe 2021-2022:

PROGRAMET	Viti I 2021-2022			Viti II 2020-2021			Viti III 2019-2020			Total
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	
Dizajn i Modës, BA	108	10	118	113	7	120	87	8	95	333
Dizajn i Komunikimit, BA	13	12	25	21	25	46	14	23	37	108
Dizajn i Enterierit, BA	11	10	21	23	7	30	4	4	8	59
Dizajn i Modës, MA	17	3	20	19	1	20	17	0	17	57
<b>Total</b>	<b>149</b>	<b>35</b>	<b>184</b>	<b>176</b>	<b>40</b>	<b>216</b>	<b>122</b>	<b>35</b>	<b>157</b>	<b>557</b>

Fig.nr.1: Numri i përgjithshëm i studentëve




Fig. 2. Numri i përgjithshëm i studentëve që ndjekin studimet në AE përfshirë statistikat gjinore

Ky raport është përgatitur nga Zyra për sigurimin e cilësisë e cila ka rolin e mekanizmit ekzekutiv të Komisionit për Sigurimin e Cilësisë. Kjo zyre udhëhiqet nga Zyrtari i cilësisë nën mbikqyrjen e drejtorit të administratës.

## **2. Menaxhimi i cilësisë**

### **2.1 Organizimi dhe procedura e sigurimit të cilësisë në Akademinë "Evolucion"**

Akademia Evolucion e realizon kontrollin e sigurimit të cilësisë përmes Komisionit për Sigurimin e Cilësisë, i cili përbëhet nga tre anëtarë: drejtorit akademik, zyrtarit të cilësisë dhe një përfaqësuesi të mësimdhënësve. Zyra e SC është një përbërje shumë dimensionale e strukturave të ndryshme brenda Akademisë "Evolucion", duke përfshirë administratën, studentët, drejtorin e administratës dhe stafin akademik, kështu që përfaqëson interesat kryesore të të gjitha palëve të interesuara, por ajo raporton direkt tek Këshilli i SC që është organi më i lartë i kontrollit të cilësisë brenda Akademisë "Evolucion".

Zyra për Sigurimin e Cilësisë ka këto detyra:

- Ekzekuton detyrat e marra nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë, si dhe raporton mbarëvajtjen e proceseve administrative dhe akademike të Akademisë "Evolucion";
- Monitoron procesin e punës së administratës;
- Bën anketimin e studentëve dhe profesorëve me anë të pyetësorëve dhe pas analizës së materialeve i raporton Komisionit për Sigurimin e Cilësisë.

Me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit të suksesshëm të procesit dhe standardit të mësimdhënies:

- Profesorët obligohen të prezantojnë sullabuset e hollësishme (dhe të përditësuara/freskuara për çdo vit) të lëndës;
- Sullabusi i lëndës iu prezantohet studentëve në kuadër të doracakut të studimeve;
- Profesorët anketohen për suksesin dhe problematikat gjatë realizimit të lëndës;
- Studentët anketohen për të parë suksesin dhe përfitimin nga lënda;
- Procesi i realizimit të materialeve raportohet dhe diskutohet në Këshillin Akademik;

Me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit të suksesshëm të procesit dhe standardit të nxënies:

- Studentët informohen për procedurat e punës dhe përmbajtjen e lëndëve me anë të doracakut të studimeve;
- Studentët anketohen me anë të pyetësorëve për cilësinë dhe procesin e studimit;
- Evidentohet prezenca dhe aktiviteti i studentit gjatë të gjitha aktiviteteve në AE;

Me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit të suksesshëm të procesit dhe standardit të punës së administratës:

- Monitorohen shërbimet e realizuara ndaj studentëve dhe profesorëve;

- Trajnohet personeli për shërbimet administrative;
- Evidentohen raportet dhe kërkesat nga administrata;
- Anketohen studentët dhe profesorët për efikasitetin e shërbimeve të administratës;

Kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë i nënshtrohet çdo segment i punës së AE'së. Procedurat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë analizimin e saktë dhe me kohë të efikasitetit të funksionimit të institucionit tonë.

Analiza e të dhënave dhe raportimi nga procedura të ndryshme - siç janë vlerësimi i studentëve dhe shërbimet akademike, vëzhgimet e mësimdhënies, si dhe të dhënat e trajnimit - kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të proceseve kryesore të menaxhimit të performancës.

### 3. Realizimi i procesit mësimor

Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është i orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të Akademisë "Evolucion", mbështetë përmirësimin e procesit mësimor, zhvillimin e punës kërkimore/artistike, dhe kontribon në zhvillimin e proceseve drejtuese e administrative në AE.

Me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit të suksesshëm të procesit dhe standardit të mësimdhënies dhe standardit të nxënies (si edhe standardeve tjera të kërkuara sipas AKA-së), vlerësimi i këtyre standardeve është realizuar në tre programet mësimore të AE-së, të organizuara në 3 departamente:

- Programi i Dizajnit të Modës, niveli Bachelor dhe Master;
- Programi i Dizajnit të Enterierit, niveli Bachelor;
- Programi i Dizajnit të Komunikimit, niveli Bachelor;




Fig. 3: Numri i studentëve në nivelin Bachelor dhe Master

Procesi mësimor gjatë vitit 2020/2021 kryesisht është zhvilluar në platformën online. AE-ja ka zbatuar në mënyrë strikte vendimet e Qeverisë, IKSHPK-ës dhe MASHT rreth masave mbrojtëse kundër virusit COVID-19. Po ashtu në mënyrë strikte janë zbatuar edhe masat lehtësuese sa i përket lejitimit të mbajtjes së provimeve dhe orëve praktike, konsultave apo edhe ligjëratave me prezencë fizike në AE, duke respektuar numrin e caktuar të studenteve në grupe.

Zhvillimi i procesit mësimor në kushtet e pandemisë së Covid-19 i ka detyruar mësimdhënësit në AE dhe studentët që t'iu përshtaten disa rregullave të reja siç janë: mbajtja e maskës, mbajtja e distancës, pjesëmarrja në mësimin praktik në programet dhe fushat e caktuara të ndarë në grupe më të vogla studentësh (vetëm nga 5 studentë në një grup) dhe duke respektuar strikt udhëzimet e IKSHPK-së dhe Qeverisë së Kosovës.

Platformat që janë përdorur për zhvillimin e mësimin online janë: google meet dhe google classroom. Këto platforma u rekomanduan sepse kishin efekte pozitive gjatë periudhës së mësimdhënies gjatë semestrit të fundit të vitit akademik 2019-2020.

Si rezultati i kësaj, u ndërmorën të gjitha veprimet teknike për shfrytëzimin e shërbimeve të platformave të lartëpërmendura, si: rikonfirmimi i llogarive të e-mailit në gmail i të gjithë studentëve dhe shkarkimi i listave të e-mailave të studentëve (sipas manualit), e më pas dërgimi i njoftimeve për ligjëratat sipas orareve nga ana e mësimdhënësve duke aplikuar platformat si vijon:

- Google Meet – për mbajtjen e ligjëratave;
- Google Classroom - për krijimin e grupeve të lëndëve, ndarjen e detyrave dhe shpërndarjen e materialeve.

Për ligjëruesit e tjerë, të cilët kishin rekomanduar platforma të tjera të mësimin në distancë, Këshilli Akademik vendosi që të vazhdonin me të njëjtat platforma, me kusht që raportet e mësimdhënies të dërgohen në mënyrë të rregullt në zyrën e sigurimit të cilësisë.

Përpos platformave të lartëpërmenduar janë përdorur edhe platforma të tjera si: Apowersoft për inçizimin e ligjëratave dhe shfrytëzimin e tyre më pas (<https://www.apowersoft.com/free-online-screen-recorder?c=1>), platforma Zoom, Skype, Viber, si dhe komunikimi përmes email-it.

Ligjëratat janë mbajtur në përgjithësi sipas orarit të planifikuar për vitin akademik 2020/2021 me një ndryshim të vogël në departamentin e Dizajnit të Modës, niveli Bachelor.

Kalimi nga ligjërimi fizik në atë online ka pasur edhe sfidat e veta, duke marrë parasysh se në Dizajn të Modës ka lëndë profesionale të cilat gjatë ligjërimin dhe ushtrimeve kërkojnë mbështetje dhe mbikqyrje të drejtëpërdrejtë të studentëve gjatë procesit të prerjes dhe qepjes.



Vështirësi të kësaj natyre janë raportuar në lëndët *Modulet e qepjes (1 dhe 2)* viti i parë dhe *Modulet e qepjes (3 dhe 4)* viti i dytë. Mësimi online në këto 2 lëndë nuk ka qenë i mundur të organizohet për arsye të specifikave të lëndëve si dhe faktit se një numër i studentëve nuk posedojnë makina qepjeje në shtëpitë e tyre dhe angazhimi në ligjerata online në këto lëndë pa paisjet përkatëse është i pamundur. Profetori dhe studentët janë dakorduar që mësimi në këto lëndë të zëvendësohen dhe të mbahen në ambientet e AE-së në momentin e parë që do të jetë e mundur. Me lirimin e masave nga Qeveria e Kosovës u mundësua që edhe këto lëndë të mbahen me prezencë fizike me grupe të vogla në AE (duke iu përmbajtur në mënyrë strikte masave mbrojtëse dhe rregullave të IKSHPK-së) duke përmbushur kështu plan programin pa humbur asnjë ligjëratë.

Ndryshim ka pasur edhe në orarin e vitit të tretë të Dizajnit të Modës, me ç'rast për shkak të specifikave dy lëndë mësimore të planifikuara në semestrin dimëror janë mbajtur në semestrin verorë:

1. Zbërthim i patronit
2. Aranzhim i veshjes në kukull

Studentët kanë qenë të informuar me kohë nga ana e profesorëve me syllabuset e lëndëve si dhe me materialin mësimor. Në bazë të raportimeve të profesorëve, mësimi online si dhe mësimi i kombinuar me prezencë fizike kanë qenë të suksesshme dhe kanë mundësuar plotësisht realizimin e plan-programit mësimor të planifikuar për vitin akademik 2020/2021.

### 3.1 Norma e kalueshmërisë së studentëve në provime

Tabela e më poshtme pasqyron normën e kalueshmërisë së studentëve në provime sipas viteve akademike të cekura në tabelë.

Programet	Norma e kalueshmërisë së studentëve në provime sipas vitit akademik		
	2020/2021	2019/2020	2018/2019
Dizajn i Modës, BA	82.67%	77.24%	86%
Dizajn i Komunikimit, BA	79.10%	75%	81.45%
Dizajn i Enterierit, BA	81.70%	79.20%	83%
Dizajn i Modës, MA	77.54%	73%	84.30%

Fig. nr.4. Kalueshmëria e studentëve në provime sipas viteve akademike

### 3.2 Numri i të diplomuarve

Numri i të diplomuarve gjatë vitit 2020, është 61 studentë (50 femra, 11 meshkuj) dhe numri i të diplomuarve gjatë vitit 2021: 75 studentë (66 femra, 9 meshkuj).

Numri prej 136 studentëve të diplomuar në Akademinë “Evolucion” në vitin akademik 2019/2020 dhe 2020/2021 si dhe studentët e tjerë që pritet të diplomojnë në vitin akademik 2021/2022 është një tregues mjaft premtues për interesimin e studentëve tanë për të studjuar në Akademinë “Evolucion” dhe një mundësinë jashtëzakonisht positive për tregun e punës në fushat që studentët tanë diplomohen.

PROGRAMET	Viti 2019-2020			Viti 2020-2021		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Dizajn i Modës, BA	40	4	44	47	1	48
Dizajn i Komunikimit, BA	3	3	6	3	5	8
Dizajn i Enterierit, BA	1	3	4	7	3	10
Dizajn i Modës, MA	6	1	7	9	0	9

Fig.nr.5. Numri i të diplomuarve

Numri total i studentëve të diplomuar në AE është pasqyruar përmes grafikut të mëposhtëm:



Fig. 6. Numri i studenëve të diplomuar përfshirë statistikat gjinore

### 3.3 Shkëputje e studimeve

Numri i studentëve të cilët i kanë shkëputur studimet gjatë vitit 2019- 2020, është 3 studentë (1 femër, 2 meshkuj);

Numri i studentëve të cilët i kanë shkëputur studimet gjatë vitit 2020-2021: është 9 studentë (8 femra, 1 meshkull);

Disa nga arsyet për shkëputje të kontratës janë: emigrimi, shkaqe familjare, punësim, shkaqe shëndetësore, financiare, mungesa e vullnetit si pasojë e pandemisë, etj.

PROGRAMET	Viti 2019/2020			Viti 2020/2021		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Dizajn i Modës, BA	1	0	1	6	0	6
Dizajn i Komunikimit, BA	0	2	2	1	1	2
Dizajn i Enterierit, BA	0	0	0	1	0	1

Fig. nr. 7: Numri i studentëve të cilët i kanë shkëputur studimet gjatë viteve 2019-2020 dhe 2020 dhe 2021

## 4. Vijueshmëria e studentëve në ligjërata

### 4.1 Semestri dimëror




Fig. 8: Mbajtja e ligjëratave sipas orarit-semestri dimëror

➤ **Dizajn i Modës**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Modës në ligjërata gjatë semestrit dimëror.




Fig.9: Vijueshmëria e studentëve DM-semestri dimëror

➤ **Dizajn i Komunikimit**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Komunikimit në ligjërata gjatë semestrit dimëror.



Fig. 10: Vijueshmëria e studentëve DK-semestri dimëror

➤ **Dizajn i Enterierit**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Enterierit në ligjërata gjatë semestrit dimëror.




Fig.11: Vijueshmëria e studentëve DE-semestri dimëror

➤ **Dizajn i Modës – niveli Master**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Modës-niveli Master në ligjërata gjatë semestrit dimëror.



Fig 12.: Vijueshmëria e studentëve DM - Master, semestri dimëror

#### 4.2 Semestri verorë




Fig. 13.: Mbajtja e ligjëratave sipas orarit-semestri verorë

#### ➤ Dizajn i Modës

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Modës në ligjëratat gjatë semestrit verorë.




Fig.14: Vijueshmëria e studentëve DM – semestri verorë

➤ **Dizajn i Komunikimit**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Komunikimit në ligjërata gjatë semestrit verorë.




Fig.15: Vijueshmëria e studentëve DK – semestri verorë

➤ **Dizajn i Enterierit**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Enterierit në ligjërata gjatë semestrit verorë.




Fig. 16: Vijueshmëria e studentëve DE – semestri verorë

➤ **Dizajn i Modës – niveli Master**

Grafiku i mëposhtëm pasqyron vijueshmërinë e studentëve të Dizajnit të Modës-niveli Master në ligjërata gjatë semestrit verorë.



Fig. 17: Vijueshmëria e studentëve DM - Master, semestri verorë

## 5. Administrata

Gjatë mbajtjes së mësimin online, stafi akademik dhe studentët janë informuar me kohë nga menaxhmenti dhe administrata e AE-së lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës, IKSHPK-ës, MASHT-it dhe AE-së për masat të cilat kanë pasur të bëjnë me procesin e organizimit të mësimin në Kosovë të shkaktuar si pasojë e pandemisë Covid-19.

Stafi i administratës si zyre për mbështetje të studentëve dhe profesorëve kanë qenë më të angazhuar se zakonisht në organizimin e grupeve më të vogla të studentëve për të vijuar provimet, konsultat, punën praktike me prezencë fizike në AE. Si rrjedhojë e kësaj situatë të shkaktuar nga pandemia dhe me qëllim që të jenë në dispozicion të studentëve dhe profesorëve, stafi i administratës ka vendosur që të shtyjë për në vitin e ardhshëm pjesëmarrjen në trajnimet e planifikuara për stafin e administratës.

Në periudhën kur me vendim të Qeverisë është dashur të punohet me staf të reduktuar, Departamenti i Administratës së Akademisë "Evolucion" është koordinuar dhe ka organizuar punën me grupe në mënyrë që studentëve dhe stafit akademik të ju mundësohet realizimi i shërbimeve të administratës në AE.

Departamenti i Administratës me të gjitha njësitë e sajë ka krijuar një përvojë të mirë pune dhe me lehtësi menaxhon punën me studentë dhe staf akademik, qoftë nëse mbahet mësimi në platformën online ashtu edhe me prezencë fizike në AE.



Angazhimi dhe puna e suksesshme e këtij Departamenti është treguar edhe gjatë procesit të regjistrimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2021/2022. Frekuentimi i shumtë i kandidatëve për tu interesuar për regjistrim, shumica të shoqëruar nga prindërit si financues të studimeve, ka bërë që ky departament të ketë komunikime të shumta me palë dhe ka qenë pasqyrë e AE-së.

## 6. Biblioteka e Akademisë "Evolucion"

Biblioteka në Akademinë "Evolucion" është një bibliotekë institucionale në shërbim të qëllimeve hulumtuese dhe arsimore të Akademisë "Evolucion". Biblioteka ka një hapësirë të përshtatshme në objekt, dhe ka një fond prej 557 libra të veçantë, me tituj të ndryshëm.

Fondi kryesor i bibliotekës është në fushat e këtyre lëndëve që mësohen në Akademinë "Evolucion", me shtimin e materialeve të përgjithshme të referencës dhe libra të njohura të interesit. Shumica e librave janë në dispozicion për 'check-out' dhe studim në shtëpi, edhe pse veprat e referencës duhet të qëndrojnë në ambientet e bibliotekës. Biblioteka gjithashtu shërben si vend qendror për shfaqje të atyre dokumenteve që janë vënë në dispozicion të komunitetit para se të paraqiten në Këshillin akademik të Akademisë "Evolucion".

Biblioteka në Akademinë "Evolucion" është dera kryesore për nevojat e studentëve dhe stafit akademik me shërbimet e nevojshme të cilat i ofron, me libra dhe materiale elektronike nëpërmjet fondit ekzistues të librave dhe databazave të disponueshme **EKON-BIZ** dhe **EBSCO**.

Gjithashtu me saktësi, efikasitet dhe në kohë të duhur janë përpunuar, janë klasifikuar dhe janë katalogizuar të gjitha librat e rinj të blerë, posaçërisht fondi i librave të donuara nga Biblioteka e Pejës me të cilën Akademia "Evolucion" ka një memorandum bashkëpunimi.

Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me Bibliotekën kombëtare të qytetit të Pejës, veçanërisht huazimit të materialeve që ne nuk i posedojmë si dhe me Bibliotekën universitare të Kosovës. Gjatë kësaj kohe biblioteka u ka kushtuar një rëndësi të posaçme edhe promovimeve të librave nga autorët vendorë me rëndësi shkencore dhe kulturore.

Akademia "Evolucion" ka prezantuar burime të reja në bibliotekë, duke bërë të mundur qasjen në disa library internacionale virtuale si:

1. Royal Borough of Kensington and Chelsea  
<https://www.rbkc.gov.uk/libraries-0/read/online-resources-and-digital-library/fashion-and-art>
2. The Architecture open library  
<https://www.architectureopenlibrary.com/>
3. Fashion Design Books  
<https://fashiondesignbooks.com.ng/>
4. Smithsonian Libraries  
<https://library.si.edu/digital-library/art-and-design>
5. Academy "Evolucion" of Art University Library.  
[https://library.Academy "Evolucion" art.edu/](https://library.Academy)

## 6.1 Shërbimet Elektronike dhe mediat sociale

Akademia "Evolucion" u ofron studentëve dhe stafit të vet një sërë shërbimesh elektronike, për komunikim dhe menaxhim efikas të proceseve të mësimdhënies dhe për mësim nxënies si:

- **Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve dhe personelit Administrativ dhe Akademik (SEMSA)** është platformë e cila është krijuar me qëllim të ofrimit të shërbimeve elektronike për Studentët dhe personelin Administrativ dhe Akademik të Akademisë Evolucion. SEMSA përbëhet nga disa module të cilat janë: moduli për regjistrimin e studentëve; moduli i notimit; moduli i pagesave studentore; moduli i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit; moduli i kompetencave dhe përmbajtjeve mësimore dhe moduli i Bibliotekës.
- **Posta elektronike zyrtare e Akademisë "Evolucion"** ju ofron studentëve dhe publikut në tërësi informacione real time, komunikim më të shpejt, informacionet bazë të programeve, rregulloreve, stafit akademik, ngjarjet dhe arritjet e studentëve, kalendare, njoftime dhe shumë mundësi të tjera të Akademisë "Evolucion" të cilat janë të disponueshëm nëpërmjet faqes së internetit: [www.akademiaevolucion.com](http://www.akademiaevolucion.com)

Përveç kësaj, Akademia "Evolucion" ka në dispozicion disa faqe në media sociale që përshkruajnë përvojat arsimore dhe ngjarje të tjera publike të organizuara nga Akademia "Evolucion":

### *Faqet zyrtare në:*

- Website: <https://akademiaevolucion.com/>
- Instagram: ( [www.instagram.com/akademia.evolucion](http://www.instagram.com/akademia.evolucion) )
- Facebook: ( [www.facebook.com/akademia.evolucion](http://www.facebook.com/akademia.evolucion) )
- Youtube: ( [www.youtube.com/channel/UCS1dxx4XRHJv1ZNbn2g9H\\_g](http://www.youtube.com/channel/UCS1dxx4XRHJv1ZNbn2g9H_g) )

- **e-Biblioteka** është një nga shërbimet që ofron dhe shfrytëzohet vetëm brenda Akademisë "Evolucion"

e-Biblioteka ju siguron studentëve të Akademisë "Evolucion" burime të mjaftueshme të marra nga çdo cep i botës, në mënyrë që ata të mund të pajisen me njohuri të mjaftueshme në jetën e tyre akademike. Përmbajtja e bibliotekës akademike paraqet një gamë të gjerë librash, revistash dhe burimesh të tjera, të cilat janë të përshtatshme në mënyrë ideale për qasjen e studentëve në mësimin e pavarur. Për më tepër, qasja e studentëve tanë në e bibliotekë mbështet kërkimin/hulumtimet e njësisive akademike, studentëve dhe të diplomuarve të Akademisë "Evolucion"

- Serveret me module për: personel, financa, paga, kontabilitet, IT
- Në gjithë hapsirën e Akademisë "Evolucion" është i shpërndarë Wi-Fi dhe mbulon gjitha hapsirat e saj.

## 7. Aktivitetet dhe projektet

Situata me pandeminë Covid-19 ka ndikuar në reduktimin e një numri të aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara të Akademisë "Evolucion", si pasojë e masave parandaluese për mbrojtje kundër Covid-19.

Gjatë vitit akademik 2020/2021 janë organizuar disa aktivitete/projekte me pjesëmarrje të profesorëve dhe studentëve në projekte të përbashkëta si:

- Prill dhe Nëntor 2021: Pjesëmarrja e njësisë akademike të Dizajnit të Modës në bashkëpunim me studentët e Akademisë "Evolucion" në eventin prestigjioz "Prishtina Fashion Night". Studentët e Akademisë "Evolucion" kanë prezantuar me sukses koleksionet e veçanta për sezonin Pranverë/Verë dhe Vjeshtë/Dimër. Në këtë event Akademia "Evolucion" merr pjesë në organizim dhe sponsorizim;
- Angazhimi i studentëve të dizajnit të komunikimit në krijimin e gazetave dhe broshurave – tipografi;
- Pjesëmarrja e studentëve të dizajnit të enterierit në projektin e dizajnit të enterierit për renovimin e klasave në departamentin e tyre, krijimi i një ambienti të ngrohtë dhe motivues për mësim;
- Bashkëpunimi i drejtoreshës ekzekutive dhe një grupi të studentëve të AE me ekipin e profesorëve dhe studentëve të Chiang Mai Polytechnic College të Tajlandës, në eventin "Rruga e mëndafsht e Tajlandës në botën e 2020", organizuar nga mbretëria e Tajlandës. Në këtë event Akademia "Evolucion" u prezantua me temën "Xhubleta në mëndafsh";
- Organizimi i punëtorisë përmes google meet (webinar) "Zero Waste Methods in Fashion Design" organizuar për studentët e vitit të parë dhe të dytë të dizajnit të modës, niveli Master;
- Nëntor 2019: Pjesëmarrja në simpoziumin e 3-të ndërkombëtar të teknologjisë së tekstilit dhe konfeksionit, i organizuar nga KAMA-USAID. Në kuadër të këtij event, Menaxhmenti i Akademisë "Evolucion" ka qenë pjesë e diskutimit për gjendjen aktuale të teknologjisë dhe zhvillimit të konfeksionit në Kosovë dhe rajon. Ndërsa një grup i studentëve ka qenë pjesëmarrës në një konkurs të organizuar brenda këtij simpoziumi si dhe kanë fituar pozicione kyçe në karrierë;
- Dhjetor 2019 -2020": Pjesëmarrja e Drejtoreshës Ekzekutive dhe Shefes së departamentit të Modës me mbështetje të ligjëruesve të Akademisë "Evolucion" në projektin kombëtar "Albania Designers Competition" e zhvilluar në "Vizion Plus" mediumin prestigjioz në Shqipëri. Në këtë projekt/garë Akademia "Evolucion" u përfaqësua suksesshëm me tre

studentë të sajë të DM të cilët për kanë fituar vendin e parë, të tretë dhe të katërt. Akademia "Evolucion" i ka shpërblyer këta studentë të suksesshëm me bursa studimi në nivelin Master në Akademinë "Evolucion";

- Trajnimi i 2 zyrtarëve të financave të AE të cilët kanë vijuar trajnimin në kontabilitetin praktikë me programin EXPERT-Aplikacion për menaxhimin e kontabilitetit material dhe financiar;
- Vizitë e koordinatorës së Zyrës së Erasmus Kosova me bashkëpunëtorët e sajë në Akademinë "Evolucion". Bisedë konkrete me drejtoreshën ekzekutive të AE-së, temë e bisedës: modernizimi, reformimi i kurrikulës dhe projektet për bashkëpunim në fushën e arsimit me synim të avancimit të punës;
- Pjesëmarrje në organizimin e diskutimit mbi " Dizajnin dhe tekstin dhe të gjitha sfidat në rugëtimin e krijimit të një dizajneri të mirëfillt", organizuar nga Organizata THY.

## 8. Anketimi

Zyra për Sigurimin e Cilësisë zbaton instrumentet e vlerësimit të përcaktuara në nenin 2 dhe 3 të Rregullores për sigurimin e cilësisë të Akademisë "Evolucion" si dhe konform Standardeve dhe Udhëzimeve Europiane të sigurimit të cilësisë.

Vlerësimet e brendshme realizohen përmes vlerësimit vetanak:

- Përmes pyetësorëve dhe vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik;
- Përmes pyetësorëve anonim të vlerësimit nga studentët;
- Përmes monitorimit të vazhdueshëm të procesit nga zyrtari i cilësisë, drejtori i administratës dhe drejtori akademik;
- Përmes analizës së parametrave të bazuar në raportet e punës dhe përmbushjes së detyrave, me ndihmën e të cilave njësitëve të kontrolluara iu përcaktohen masat që duhet marrë për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë;
- Pas përfundimit të çdo vlerësimi të raporteve dhe monitorimit të procesit të punës përgatitet raporti me shkrim lidhur me procedurën e vlerësimit, rezultatet dhe masat e propozuara;
- Rezultatet e raportit shqyrtohen nga Komisioni për sigurimin e cilësisë dhe shërbejnë si bazë për planet e mëtejme për përmirësim dhe sigurimin e cilësisë në Akademi;
- Zyra për sigurimin e cilësisë implementon rekomandimet dhe realizon detyrat e marra nga Komisioni për sigurimin e cilësisë.

Janë realizuar pyetësor të ndryshëm duke filluar nga pyetësorët për studentet fillestarë, pyetësorët semestral për studentë, pyetësorët për vetëvlerësimin e profesorëve, vlerësimin e administratës, pyetësori për mësimin online, vlerësimi nga stafi administrativ, pyetësor për studentët gjatë procesit të diplomimit, anketimi i të diplomuarëve.

Rezultatet dhe rekomandimet e dala nga pyetësorët janë paraqitur në raportet përkatëse për secilin pyetësor, përgatitur nga zyra për sigurimin e cilësisë.

## 9. Regjistrimi i studentëve të rinj për vitin akademik 2021/2022

Procesi i mësimet për vitin akademik 2021/2022 në Akademinë "Evolucion" ka filluar në nivelin Bachelor më 16.10.2021 dhe në nivelin Master më 30.11.2021. Mësimi zhvillohet kryesisht me prezencë fizike në përjashtim të disa lëndëve teorike të cilat mbahen online.

Fillim viti po zhvillohet normalisht, aktivitetet mësimore po zhvillohen sipas orarit dhe plan programit të planifikuar mësimor në programet në vijim:

- Programi i Dizajnit të Modës, niveli Bachelor dhe Master;
- Programi i Dizajnit të Enterierit, niveli Bachelor;
- Programi i Dizajnit të Komunikimit, niveli Bachelor;

Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2021/2022 është:

PROGRAMET	Viti i I-rë		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Dizajn i Modës, BA	108	10	118
Dizajn i Komunikimit, BA	13	12	25
Dizajn i Enterierit, BA	11	10	21
Dizajn i Modës, MA	17	3	20
<b>Gjithsej:</b>	149	35	184

Fig.18. Numri i studentëve, viti akademik 2021/2022

## 10. Konkluzion

Përmes aktiviteteve të vlerësimit, monitorimit, anketimeve, intervistave dhe pyetësorëve synohet identifikimi i praktikave të mira si dhe identifikimi i situatave të cilat kërkojnë ndërhyrje për të përmirësuar gjendjen aktuale aty ku është e nevojshme.

Zyra për sigurimin e cilësisë nuk ka hasur në ndonjë problem për të realizuar procesin e punës së vet në Akademinë "Evolucion". Është punuar duke u bazuar në Rregulloren për sigurimin e cilësisë të Akademisë "Evolucion" si dhe konform Standardeve dhe Udhëzimeve Europiane të sigurimit të cilësisë.

Vlen të theksohet se nuk ka munguar bashkëpunimi në mes të ZSC me akterët e përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë, sepse për të gjithë ka qenë i kjo parimi që vlerësimi bëhet për të përmirësuar e jo për të paragjykuar.

Përkundër të gjitha sfidave të shkaktuara nga pandemia Covid-19, mund të konkludohet se viti akademik 2020/2021 u përmyll suksesshëm. Në këtë sukses dukshëm ndikoj edhe përvoja e fituar e profesorëve, studentëve, menaxhmentit dhe stafit të AE-së për menaxhimin e mësimin online, përvojë kjo e fituar që nga viti 2020 kur u kalua për herë të parë në mësimin e platformës online.

Plan programi mësimor gjatë vitit akademik 2020/2021 u realizua plotësisht, nuk ka orë të humbura. Orët të cilat nuk janë mbajtur për shkak të kalendarit të festave shtetërore apo anulimeve eventuale të orëve nga profesorët (për shkaqe shëndetësore apo të ndryshme) janë realizuar gjatë po këtij viti akademik.

Akademia "Evolucion" gjatë gjithë vitit akademik i është përmbajtur dhe vazhdon t'i përmbahet në mënyrë strikte masave të përcaktuara parandaluese kundër virusit Covid-19, duke siguruar kështu një ambient të sigurtë pune për të gjithë stafin (akademik, menaxherial, administrativ) dhe studentët e sajë.

Sa i përket kyçjes në platformat online nuk ka pasur raportime për ndonjë problem i cili ka ndikuar në mosmbajtjen e ligjëratave. Profesorët e AE-së përpos ligjëratave, ushtrimeve dhe kontrollimit të detyrave janë marrë edhe me mentorimin e diplomave Bachelor dhe Master duke iu përmbajtur plan-programit të vitit akademik 2020//2021.